



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Milenium Konstruktion" Sh.P.K. të datës 07.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 02.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës Llot II" me nr. të prokurimit 616-22-11624-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 176 511, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Milenium Konstruktion" Sh.P.K. e datës 07.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 02.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës Llot II" me nr. të prokurimit 616-22-11624-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 176 511.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Milenium Konstruktion" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Milenium Konstruktion" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 07.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 02.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës Llot II" me nr. të prokurimit 616-22-11624-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 176 511.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetçur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet themelore të parashtruesit janë si në vijim:

- I. Parashtruesi i kundërshton edhe arsyet e eliminimit të tij për faktin se ka ofertuar me çmim jo normalisht të ulët në pozicionin 4.2 duke shtuar se "*pozicioni 4.2 – furnizim me beton dhe 4.3 – furnizim me armaturë nuk punohen ndaras dhe kur punohen këto dy pozicione së bashku atëherë çmimi për 1m³ beton me armaturë del të jetë 290 euro*" (shih faqen nr. 7 të kërkesës për rishqyrtim)
- II. Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 të LPP dhe nenin 41 të RRPP pasi që nuk ka kërkuar sqarime nga tenderuesi i rekomanduar për çmimet jo normalisht të ulëta nga tenderuesi i rekomanduar (shih faqen nr. 3 të kërkesës për rishqyrtim). Grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë "Victory" Sh.P.K. & "Marisa" Sh.P.K. & "Company Murseli" Sh.P.K. ka dorëzuar "*paramasën e cila në tërësinë e saj përbën tender jo normalisht të ulët për faktin se nëse krahasohet me objektin e kontratës ka dallime substanciale në raport me çmimet reale të tregut*" (shih faqen nr. 3 të kërkesës për rishqyrtim).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 15.08.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor të parashtruesit duhet sqaruar se përmes letrës për tenderuesin e pasuksesshëm arsyet për eliminimin e parashtruesit janë evidentuar si në vijim:

- '*për pikën 1 sqarimet që keni dërguar për AK nuk janë bindëse, janë të pa qarta për arsye se ne kemi kërkuar siç jemi obliguar me vendimin e OSHP për të kërkuar sqarime konform nenit 61 të LPP për pozicionin 4.2. Ju përveç pozicionit që ju kemi kërkuar sqarime keni përfshirë edhe një pozicion tjetër që për AK përgjigja juaj lidhur me sqarimet e kërkuara nuk është e argumentuar dhe as bindëse, përkundrazi ju përmes përgjigjes tuaj keni konfirmuar se çmimi i ofruar nga ju në pozicionin 4.2 është jo normalisht i ulët kurse sipas dokumenteve të prezantuara pas kërkesës për sqarime ju vet keni argumentuar se çmimet e tregut aktualisht janë shumë më të larta, prandaj edhe jeni eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit'.*

Në rastin konkret nuk është kontestues fakti që tenderuesi i rekomanduar për pozicionin 4.2 të paramasës – Furnizimi, transporti, kallëpimi, vendosja, kompaktimi i betonit të klasit C25/30 për themele, mure dhe lëshesë betonarme ka ofertuar me vetëm 10 euro. Njëkohësisht nuk është as kontestues fakti që me datë 13.07.2023 Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime nga parashtruesi për shkak të çmimeve jo normalisht të ulëta. Me datë 17.07.2023 parashtruesi është përgjigjur sikurse është elaboruar më sipër në letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.

Nëse analizohet me kujdes pretendimi ankimor, mund të kuptohet se as vet parashtruesi nuk e ka kontestuar faktin se ka ofertuar me çmim jo normalisht të ulët për pozicionin 4.2 të paramasës. Për më tepër sqarimi që ka dërguar por edhe pretendimi ankimor nuk ndërlidhet fare me pozicionin 4.2 por ndërlidhet me pozicionin 4.3. Kuptohet që pozicionet në paramasë janë të ndara prej njëri tjetrit dhe për secilin pozicion veçmas duhet të ofertuar çmimi përkatës. Argumenti që ka përdorur parashtruesi se pozicioni 4.2 dhe 4.3 duhet të trajtohen si një pozicion i vetëm është argument jo vetëm i kundërligjshëm por edhe i palogjikshëm pasi që në këndvështrimin e përgjithshëm të gjitha pozicionet ndërlidhen mes vete sepse i përkasin një projekti të caktuar për të cilin është duke u zhvilluar aktiviteti i prokurimit. Duhet theksuar se me datë 02.05.2023 OSHP ka marrë vendimin PSH.Nr. 61/23 përmes të cilit është miratuar si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik NSHT "Victory Com" kundër vendimit të autoritetit kontraktues përmes të cilit është rekomanduar për kontratë parashtruesi "Milenium Konstruktion" Sh.P.K. për Llotin 2 ashtu që aktiviteti i prokurimit është kthyer në rivlerësim. Në faqen 5 të këtij vendimi të OSHP, Paneli Shqyrtues ndër të tjera potencon se "*vetëm sasia e cementit e cila duhet të përdoret për 1m³ beton të gatshëm që është 6 thasë/50kg x 7.5 euro = 45 euro, e tejkalon për së paku katër herë çmimin e dhënë me ofertë për këtë pozicion me 10 euro*". Në këtë mënyrë rezultojnë se veprimet e Autoritetit Kontraktues duke përfshirë në veçanti arsyetimet për eliminimin e parashtruesit janë në përputhje të plotë me të gjeturat dhe përfundimet e Panelit Shqyrtues sipas vendimit PSH.Nr. 61/23. **Prandaj pretendimi i parë ankimor është i pabazuar në tërësi.**

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor të parashtruesit fillimisht duhet cekur se përmes nenit 41 paragrafit 41.3 të RRPP është përcaktuar se "*Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:*

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;*
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;*
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë".*

Përmes kërkesës për rishqyrtim nuk është fare kontestues fakti se në rastin konkret nuk janë plotësuar asnjë nga tri (3) kriteret e përcaktuara përmes nenit 41 paragrafit 41.3 të RRPP sikurse është cituar më sipër. Konkretisht nuk është fare kontestues fakti që janë dorëzuar më shumë se tre (3) tenderë sipas kriterit të tretë (iii). Sa i përket kriterit të dytë, bazuar në njoftimin mbi vendimin çmimi i ofertuar nga tenderuesi i rekomanduar është 8.59 ndërsa çmimi i tenderit të dytë më të ulët është 9.38. Në rastin konkret çmimi i tenderuesit të rekomanduar për kontratë është vetëm 8.42% më i ultë se çmimi i tenderit të dytë me rradhë që është dukshëm më pak sesa 10%. Kështu mund të konfirmohet se nuk është plotësuar as kriterit i dytë (ii). Ndërsa sa i përket kriterit të parë (i) duhet cekur mesatarja e çmimeve të ofertuara është 11.77. Kjo nënkupton se çmimi i ofertuar nga tenderuesi i rekomanduar është vetëm 27% më i ulët se mesatarja e çmimeve të ofertuara nga tenderuesit që është dukshëm më pak sesa 30%. Kështu mund të konfirmohet se nuk është plotësuar as kriteri i tretë (iii).

Nga sa u tha më sipër është evident fakti që nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara përmes nenit 41 paragrafit 41.3 të RRPP. Rrjedhimisht nuk janë përmbushur as kriteret sipas do të cilave do të ishte detyruar komisioni vlerësues që të kërkoj sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar lidhur me çmimet jo normalisht të ulëta. Kjo nënkupton që komisioni vlerësues nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 41 të RRPP lidhur me nenin 61 të LPP sikurse ka pretenduar parashtruesi. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i dytë ankimor është i pabazuar në tërësi.

Vlen të potencohet se në kërkesën e tij për rishqyrtim parashtruesi në kuadër të pretendimit se tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulët ka veçuar pozicionin 1.1, 1.2, 3.2, 3.3, 3.4, 4.1 dhe 5.1 të paramasës. Megjithatë parashtruesi të vetmin argument që e ka prezantuar është se "çmimi i ofertuar nga ana e OE në fjalë është shumë më i ulët se çmimi mesatar real i tregut". Në asnjë moment parashtruesi nuk ka treguar se si e ka kalkuluar çmimin e tregut përkatësisht mbi cilën bazë ligjore dhe logjike e ka mbështetur një kalkulim të tillë. Me fjalë të tjera parashtruesi për asnjë nga pozicionet e potencuara nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme sipas të cilave do të mund të konfirmohej pretendimi i tij ankimor. Në anën tjetër nga sa u tha më sipër vet parashtruesi ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta prandaj edhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit. Ky fakt është konfirmuar edhe nga vendimi i OSHP të cituar si më sipër përveç se edhe nga komisioni për rivlerësim.


Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 15.08.2023

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.